



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ - DEGA E GJYKATËS KAÇANIK

Numri i lëndës: 2023:083991

Datë: 14.01.2025

Numri i dokumentit: 06709260

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ-Dega në Kaçanik, Departamenti i përgjithshëm-divizioni civil, gjyqtari Riza Livoreka, si gjyqtar individual, me bashkëpunëtorin profesional Ismail Kuçi, duke vendosur në çështjen kontestimore-juridiko civile të paditësve M.D, E.M, H.Zh, M.K, A.K dhe I.L të gjithë nga Kaçaniku, të cilin me autorizim e përfaqëson N.R avokat nga Kaçaniku, kundër të paditurës Komuna e Kaçanikut, të cilën e përfaqëson me autorizim H.G nga Kaçaniku, për çështjen kontestuese pagesa se diferencës në pagë, në seancën kryesore të mbajtur me datën 08.01.2025, në praninë e të autorizuarve të palëve ndërgjyqëse, ndërsa me datën 14/01/2025, bëri përpilimin me shkrim të këtij:

A K T G J Y K I M

I. MIRATOHET në tërësi si e bazuar kërkesëpadia e paditësve : M.D, E.M, H.Zh, M.K, A.K dhe I.L, të gjithë nga Kaçaniku dhe DETYROHET e paditura Komuna e Kaçanikut që paditësve të jau paguaj diferencën në pagë, kontributet pensionale dhe tatimi në pagë siç vijon:

- M.D për periudhën nga data 01.12.2018 e deri 31.12.2022, të ja pagua edhe atë: Shumën prej: 2,998.08€, në emër të diferencës në pagë, shumën prej 350.60€, për kontributin pensional nga i punësuar dhe punëdhënësi dhe shumën prej 333.12€, në emër të tatimit në pagë, e të gjitha në shumë të përgjithshme prej 3,681.75€.

- E.M për periudhën nga data 01.12.2014 e deri 31.12.2022, të ja pagua edhe atë Shumën prej: 5,555.47€, në emër të diferencës në pagë shumën prej 649,76, për kontributin pensional nga i

punësuar dhe punëdhënësi dhe në emër të tatimit në pagë e prej 617.27€, e të gjitha në shumë të përgjithshëm 6,822.50€.

-H.Zh për periudhën nga data 01.12.2014 e deri 31.12.2022, të ja pagua edhe atë: Shumën prej: 4,945.09, në emër të diferencës në pagë shumën prej 587.38€, për kontributin pensional nga i punësuar dhe nga punëdhënësi dhe shumën prej 567.80, në emër të tatimit në pagë, e në shumë të përgjithshme prej 6.091.27€.

-M.K për periudhën nga data 01.12.2014 e deri 31.12.2022, të ja pagua edhe atë: Shumën prej: 5,607.68€, në emër të diferencës, në pagë, shumën prej 655.86€, për kontributin pensional nga i punësuar dhe punëdhënësi dhe shumën prej 623.08€ dhe emër të tatimit në pagë e në shumë të përgjithshme prej 6,886.62€.

-A.K për periudhën nga data 01.12.2014 e deri 31.12.2022, të ja pagua edhe atë: Shumën prej: 5,607.68€, në emër të diferencës, në pagë, shumën prej 655.86€, kontributin pensional nga i punësuar, dhe punëdhënësi dhe shumën prej 623.08€, në emër të tatimit në pagë e në shumë të përgjithshme prej 6,886.62€.

-I.L për periudhën nga data 01.12.2014 e deri 30.04.2018, të ja pagua edhe atë: Shumën prej: 2,233.28€, në emër të diferencës, në pagë shumën prej 261.20€, kontributin pensioanal nga i punësuar dhe punëdhënësi dhe shumën prej 248.18€, në emër të tatimit në pagë e në shumë të përgjithshme prej 2,742.62€, për periudhën 01.12.2014 deri më datën 30.04.2018.

Shumë prej 33,111.41 me kamatë prej 8% duke filluar nga data 08.01.2025 (data e marrjes së aktgjykimit) e deri në pagesën definitive,

II. Refuzohet kërkesa e palës së paditur me të cilën ka kërkuar që kjo gjykatë të shpallet jo kompetente dhe lënda ti dërgohet Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për qështje Administrative e PA BAZUAR.

III. DETYROHET, e paditura, që paditësit t'ia paguaj shumën si në pikën I të dispozitivit dhe shpenzimet e procedurës kontestimore në shumë prej: 3,357.60€, të gjitha këto pagesa të bëhen në afat prej 15 ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

A r s y e t i m

Paditësit përmes të autorizuarit si në padi ashtu në seancën përgatitore dhe në seancat kryesore, ka kërkuar nga Gjykata që kërkesëpadinë e paditësve ta miratoj në tersi si të bazuar dhe ta detyroj të paditurën që paditësve të i'a paguaj diferencën në pagë, kontributet pensionale nga punëdhënësi, punëmarrësi dhe tatimi në pagë për secilin paditëse edhe atë:

- M.D për periudhën nga data 01.12.2018 e deri 31.12.2022, të ja pagua edhe atë: Shumën prej: 2,998.08€, në emër të diferencës në pagë, shumën prej 350.60€, për kontributin pensional nga i punësuarit dhe punëdhënësi dhe shumën prej 333.12€, në emër të tatimit në pagë, e të gjitha në shumë të përgjithshme prej 3,681.75€.

- E.M për periudhën nga data 01.12.2014 e deri 31.12.2022, të ja pagua edhe atë Shumën prej: 5,555.47€, në emër të diferencës në pagë shumën prej 649,76, për kontributin pensional nga i punësuarit dhe punëdhënësi dhe në emër të tatimit në pagë e prej 617.27€, e të gjitha në shumë të përgjithshme 6,822.50€.

-H.Zh për periudhën nga data 01.12.2014 e deri 31.12.2022, të ja pagua edhe atë: Shumën prej: 4,945.09, në emër të diferencës në pagë shumën prej 587.38€, për kontributin pensional nga i punësuarit dhe nga punëdhënësi dhe shumën prej 567.80, në emër të tatimit në pagë, e në shumë të përgjithshme prej 6.091.27€.

-M.K për periudhën nga data 01.12.2014 e deri 31.12.2022, të ja pagua edhe atë: Shumën prej: 5,607.68€, në emër të diferencës, në pagë, shumën prej 655.86€, për kontributin pensional nga i punësuarit dhe punëdhënësi dhe shumën prej 623.08€ dhe emër të tatimit në pagë e në shumë të përgjithshme prej 6,886.62€.

-A.K për periudhën nga data 01.12.2014 e deri 31.12.2022, të ja pagua edhe atë: Shumën prej: 5,607.68€, në emër të diferencës, në pagë, shumën prej 655.86€, kontributin pensional nga i punësuarit, dhe punëdhënësi dhe shumën prej 623.08€, në emër të tatimit në pagë e në shumë të përgjithshme prej 6,886.62€.

-I.L për periudhën nga data 01.12.2014 e deri 30.04.2018, të ja pagua edhe atë: Shumën prej: 2,233.28€, në emër të diferencës, në pagë shumën prej 261.20€, kontributin pensional nga i punësuar dhe punëdhënësi dhe shumën prej 248.18€, në emër të tatimit në pagë e në shumë të përgjithshme prej 2,742.62€, për periudhën 01.12.2014 deri më datën 30.04.2018.

I autorizuari i paditësve, ka deklaruar se e paditura, nuk ka vepruar sipas parashtresës së datës 20.11.2014, e lëshuar nga DASHC/MAP-0415/71, për vendosjen e koeficientit sipas pozitës përkatëse të lëshuar nga Ministria e Administratës Publike të Shërbimit Civil. Me këtë shkresë e paditura ka qen e obliguar që ta bajë harmonizimin dhe standardizimin e koeficienteve për pozitat e përshkruara, dhe ka qen e obliguar që këtë ndryshime ti bajë deri më datën 10.12.2014, ti harmonizoj akte emërimet dhe koeficientet dhe të njëjta ti dërgojnë në divizionin e pagave në MAP-DASHC. Kjo parashtresë ka qen obligim që të zbatohet dhe funksionalizohet i cili fakt vërtetohet nga parashtresa e datës 20.11.2014.

E paditura nuk i ka harmonizuar dhe funksionalizuar koficent për pozita e përshkruara si në parashtresën e datës 20.11.2014, me çka e njëjta ka dëmtuar paditësit në aspektin material duke mos u mundësuar që të marrin pagat sipas harmonizimit.

Paditësit nuk kanë qenë të njohur me parashtresën datës 20.11.2014, për të cilën ka kuptuar rastësisht, gjatë bisedës me zyrtaret e ministrisë rreth koeficientit, kjo parashtresë nuk është funksionalizuar nga zyra e personelit. Paditësit përmes të autorizuarit kanë tentuar që këtë çështje ta zgjidhin me marrëveshje duke ju drejtuar me kërkesën e datës 23.03.2023, po kjo marrëveshje nuk është arritur.

I autorizuari i paditësve ka theksuar se lartësia e dëmit tek paditësit është vërtetuar nga ekspertiza dhe plotësimi i ekspertizës financiar nga eksperti gjyqësor Prof.Ass.Dr. V.I. Ka propozuar që kësaj ekspertizë gjykata ja fali besimin, sepse është punuar është punuar në mënyrë profesionale dhe e ka pasqyruar gjendjen faktike të dëmit të cilin e kanë pësuar paditësit.

I autorizuari paditësve edhe gjatës seancave të mbajtura edhe në fjalë përfundimtare, i ka propozuar gjykatës, që kërkesëpadinë ta miratoj në tersi si të bazuar, për arsye se nga provat e administruara gjatë këtij procesi gjyqësor është vërtetuar se për shkake të mos veprimit të paditurës ka ardhur deri tek shkaktimi i dëmit, i cili është vërtetuar me plotësimin e ekspertizës financiare.

Shpenzimet i ka kërkuar.

E autorizuar e të paditurës, si në përgjigje në padi, ashtu në provat e bashkangjitura dhe deklarimeve të bëra në seanca, ka kërkuar nga gjykata që të shpallet jo kompetente në pikëpamje lëndore, për të vendosur në këtë çështje për pagesën e diferencës në koeficient dhe pasi lënda të bëhet e plotfuqishme ti dërgohet Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për çështje Administrative, konform Ligjit 06/L-054, nenit 12 paragrafi 4 dhe nenit 17 paragrafi 1. Po ashtu konform nenit nenit 27 paragrafi 3 Ligjit 08/1-197, për Zyrtarët Publik.

Po ashtu i ka kundërshtuar edhe pretendimet e paditësve, se e paditura nuk ka marrë veprime për ta bër harmonizimin dhe vendosjen e koeficientëve sipas pozitës edhe pse një gjë të tillë e ka pas për obligim ta bëjë duke ju referuar shkresës së datës 20.11.2011, e lëshuar nga DASHC-Ministria e Administratës Publike.

E paditura ka theksuar, se nuk qëndrojnë pretendimet e paditësve, se e paditura ka qen e obliguar ta bëjë këtë veprim, sepse nga shkresa DASHC-MAP, me numër 6038 e datës 20.11.2014, në paragrafin e fundit është shënuar se : Në institucionet që ndryshimet prodhojnë kosto të re financiare në kategorinë e pagave dhe mëditjeve, realizimi i këtyre ndryshimeve për sistemin e pagave bëhet vetëm atëherë kur kjo të jetë në harmoni me planifikimet buxhetore. Në vazhdimësi kemi komunikuar me nivelin qendror dhe kemi pranuar qarkore informuese për mes të cilave jemi informuar se nuk lejohet ngritja që në organizatat buxhetore të ngritet niveli i koeficientit.

Tutje ka theksuar se shkresa e datës 20.11.2014, nuk iu është adresuar kryetarëve të komunave, por institucioneve që kanë aprovuar rregulloren numër 09/2019. E paditura në vazhdimësi ka bër përpjeke për harmonizimin dhe vendosje për pozitën udhëheqës dhe pas kompletimit të lëndës, konfirmimit për disponueshmerin e mjeteve buxhetore më datën 10.10.2022, e ka dorëzuar për procesin në ministrin përgjegjëse për financa përkatësisht thesar. Ministria e Financave për mes shkresës elektronike të datës 22.10.2022 dhe 16.11.2022, na ka informuar se këto ndryshime nuk mundë të bëhen.

Paditësit ju kanë drejtuar këshillit të pavarure mbikëqyrës për shërbimin civil të Kosovës dhe ky organ ka nxjerr vendimin me numër 572/2023 dhe e ka përfunduar procedurën administrative dhe palën e pa kënaqur e ka udhëzuar të inicioj konfliktin administrativ.

Prandaj duke i pasur për bazë këto fakte të konstatuar i ka propozuar gjykatës nëse nuk shpallet jo kompetente kërkesëpadinë e paditësve ta refuzojë në tersi si të pa bazuar sepse paditësit këtë damë nuk e kanë pësuar me fajin e të paditurës por për shkak të pengesave ligjore.

Shpenzimet nuk i ka kërkuar

Për të vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë gjendjen faktike, në këtë çështje kontestimore pagimit i diferencës në pagë, gjykata bëri administrimin e këtyre provave: U lexuan provat: Plotësimi i akt-mërimi i datës 05.11.2028, Akt emërimi i datës 06.11.2012, Akt emërimi i datës 31.12.2012, Akt emërimi i datës 06.11.2012, Akt emërimi i datës 21.12.2012, Shkresa e datës 20.11.2024, Kërkesë për pagesën e diferencës, Përgjigja në padi, Vendimi i datës 19.01.2023, Vendimi i datës 03.04.2023, Njoftimi për konfirmimin e mjeteve buxhetore, Vendimi i datës 14.10.2022, Komunikimet elektronike në 4 faqe, Përgjigja në ankesë e datës 13.01.2023, Ndryshimi dhe plotësimi i akt emërimit i datës 01.09.2018, Akt emërimi i datës 25.10.2012, Përgjigja në padi, Menaxhimi i punësimit pagave dhe mëditjeve, Qarkorja informuese, Interpretimi i kërkesës e datës 04.04.2012, Qarkore administrative nr.01/14, Aprovimi dhe autorizimi i konkursit për udhëheqës të gjendjes civile, shpallja e dhe rekrutimi , Vendimi i datës 24.10.2018, Vendimi i datës 14.10.2022, Komunikimet elektronike në 4 fleta, Ekspertiza e ekspertit financiarë, Komunikimi elektronik i datës 09 tetor 2024, Vendimi i datës 09.3.2021, Lista e pagave, Vendimi i datës 01.03.2018, Listat e pagave Deklarata e ekspertit V.I, Plotësimi i ekspertizës financiare, pa vërejtje,

Gjykata pas vlerësimit me kujdes dhe me ndërgjegje të secilës provë veç e veçjanë dhe të gjithave bashkërisht e në pajtim me dispozitat e nenit 8 të LPK-së, dhe bindjes së lirë të kësaj gjykate, kjo gjykatë lidhur me këtë çështje kontestimore juridiko-civile vërtetoi këtë gjendje faktike:

Paditësit, janë të punësuar tek e paditura, paditësit është dashur të paguhen me koeficient 8.5 dhe nuk janë paguar. E paditura nuk ka vepruar sipas parashtrësës së datës 20.11.2014, nga mos veprimi i të paditurës paditësit kanë pësuar dëm në vlerat e caktuar si në dispozitiv të Aktgjykimit, ndërsa lartësia e dëmit është konstatuar nga ekspertiza e ekspertit financiar.

a) Se paditësit janë të punësuar teke e paditura, këtë fakt gjykata e ka vërtetuar nga Plotësimi i akt-emërimeve të datës 05.11.2028, Akt emërimi i datës 06.11.2012, Akt emërimi i datës 31.12.2012, Akt emërimi i datës 06.11.2012, Akt emërimi i datës 21.12.2012, nga të cilat vërtetohet se paditësit janë në marrëdhënie punë, ky fakt nuk ishte kontestues në mes palëve ndërgjyqëse.

b) Se paditura paditësit i ka paguar me kofecient më të ulët, ky fakt është vërtetuar nga ndryshimi dhe plotësimi i akt-emërimit dhe akt-emërimet, nga të cilat vërtetohet se paditësja M.D, është paguar me kofecient 7.5, E.Mme kofecient 8, H.Zh me kofecient 7.5, M.K me kofecient 7.5, A.K me kofecient 7.5 dhe I. L me kofecient 7.5 , a është dashur që këta të paguan me kofecient 8.5.

c) Se e paditura nuk ka vepruar sipas parashtrës së datës 20.11.2014, këtë fakt gjykata e ka vërtetuar nga thëniet në padi , përgjigje në padi, provat e bashkangjitura me padi. E paditura ka theksuar se kjo shkresë e lëshuar nga MAP në vitit 2014, kjo vetëm ka shërbyer si njoftim dhe nuk është vendim dhe nuk ka fuqi obliguese.

ç) Se për shkak se të mos veprimit të paditurës paditësit kanë pësuar dëm secili veç e veç si në precizimin e kërkesë padisë, ndërsa shumat e demit material janë vërtetuar nga ekspertiza dhe plotësimi të ekspertizës të ekspertit financiar V.I, i cili ka konstatuar se sa është dëmi për secilin paditës si rezultate i mos ndryshimit të kofecientit nga e paditura.

Gjykata pas analizimit të thënieve në padi, provave të bashkangjitura, përgjigjes në padi ekspertizës financiare dhe plotësimit të saj ka gjetur se kërkesëpadija e paditësve është e bazuar. Gjykata ka gjetur se pala e paditur, nuk ka vepruar sipas shkresës së datës 20.11.2014, e lëshuar nga Republika e Kosovës-Qeveria-Ministria e Administratës Publike respektivisht Departamenti i Administratës se Shërbimit Civil, me të cilën shkresë në paragrafin 1 është shënuar se ka vërejtur se disa institucione nuk i kanë vendosur kofecientet në nivel të pozitës dhe detyrave të punës, ndërsa me paragrafin 2 të kësaj shkrese në rreshtin fundit dhe parafundit është shënuar obligohen sekretarët e përgjithshëm të ministrive, drejtorët e agjencive ekzekutive dhe menagjerit e personelit që ta bënin harmonizimin, standardizimin e kofecientet për pozitat.

Po ashtu ky fakt vërtetohet edhe nga vendimi i datës 14.10.2022, i lëshuar nga Komuna e Kaçanikut ku është urdhëruar rritja e këtyre kofecienteve dhe në arsyetim të këtij vendimi është shënuar se me qen nuk kemi qen në dijeni me këtë shkrese të lëshuar nga DAP/MAP janë

potencuar edhe pozitat apo tituj e vendeve te punës që janë të njëjta në institucionin tone apo janë të barasvlershme me to dhe duke u siguruar se kemi mjete te mjaftueshme financiare në kategorinë paga dhe mëditje duke qen pjesë e planit buxhetor për vitin e ardhshëm kemi konstatuar se mund të bëjmë ngritjen e koeficientit për nëpunësitë civil që janë në këtë pozita.

Gjykata ja fali besimin kërkesë padisë së paditësve, sepse e njëjta është e bazuar në dokumentet publike edhe atë shkresën e datës 20.11.2014, dhe vendimin e datës 14.10.2022. Këtyre dokumenteve gjykata ja fali besimin sepse janë hartuar nga ana e organit. Dokumenti i par i datës 20.11.2014, është lëshuar nga Republika e Kosovës-Qeveria-Ministria e administratës Publike Departamenti për Administrimit të Shërbimit Civil, ndërsa vendimi i dytë është lëshuar nga Komuna e Kaçanikut dhe këto dokumente kanë fuqi provuese.

Me nenin 329 par.1 të LPK-së, është paraparë se shkresa të cilat janë hartuar në formën e caktuar nga organi shtetërorë brenda kufijve të kompetencës së vet, si dhe shkresat të cilën në formë të tillë e ka hartuar ndërmarrja apo organizata tjetër në ushtrimin e autorizimeve publike që janë besuar me ligj (Dokumentit publike), provon saktësinë e asaj që konfirmohet apo caktohet në te.

Gjykata e miratoi kërkesëpadinë e paditësve, sepse paditësit këtë damë e kanë pësuar për shkak të mos veprimit të paditurës, sipas shkresës së datës 20.11.2014, për vendosjen e koeficienteve, paragrafi 2 dhe 8 të kësaj shkrese. Gjykata e miratoi kërkesëpadinë e paditësve duke u bazuar edhe në nenin 136 të LMD-së, me të cilën dispozitë është paraparë se kush i shkakton dëm tjetrit, ka për detyrë të ja kompensoj, e në rastin konkret e paditura nuk ka vepruar sipas shkresës së datës 20.11.2014 dhe paditësit kanë pësuar dam.

Prandaj gjykata duke i pasur për bazë këto fakte të vërtetuara si dhe i konform dispozitav të neneve 55 par 1,2,3,5 dhe 6, të Ligjit të Mardh enjës së Punës, vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata lartësinë e kërkesëpadisë e ka vërtetuar nga ekspertiza dhe plotësimi i ekspertizës së ekspertit financiar, i cili në mënyrë detale e ka konstatuar se sa është dëmi i paditësve të cilin e kanë pësuar paditësit si rezultate i mosë rritjes së koeficienteve.

Meqenëse e padituri ka rënë në vonesë me kompensimin e dëmit, Gjykata me kërkesën e paditësve dhe në bazë të nen.382 të LMD-së, e detyroi të paditurën që paditësve, në shumën prej 33.111.41€, t'ia paguaj edhe kamatën prej 8%, duke filluar nga data 08.01.2025 (data e seancës kryesore), e deri në pagesën përfundimtare.

Gjykata e pranoi edhe zgjerimin e padis në aspektin subjektiv, për paditësin I.L., sepse zgjerimi i padisë është bërë konform nenit 258 të LPK-së.

Gjykata i analizoi theksimet e palës paditëse e cila i ka propozuar gjykatës se kërkesëpadinë e paditësve ta miratoi në tersi si të bazuar dhe ta detyroi të paditurën që paditësve që tija paguaj shumën si në precizimin e kërkesëpadisë.

Këtyre theksimeve gjykata u fali besimin sepse e paditura Komuna e Kaçanikut nuk ka vepruar sipas shkresës së datës 20.11.2014, me të cilën shkresë është shënuar se ka vërejtur se disa institucione nuk i kanë vendosur koeficientet në nivel të pozitës dhe detyrave të punës, ndërsa me paragrafin 2 të kësaj shkrese në rreshtin fundit dhe parafundit është shënuar obligohen sekretarët e përgjithshëm të ministrive, drejtorët e agjencive ekzekutive dhe mengjeret e personelit që ta bëni harmonizimin standardizimin e koeficientit për pozitat, paditura është dashur të veproj sipas kësaj shkrese deri më datën 10.12.2014, ti harmonizoj akt-emërimet dhe koeficientet për pozitat e larte përmendura dhe ti dërgoi në divizionin e pagave në MAP/DASHC.

Gjykata i analizoi edhe theksimet e të autorizuarit të paditurës, i cili i ka propozuar gjykatës që të shpallet jo kompetente dhe lëndën tija dërgoj Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për çështje Administrative, këto pretendime nuk i mori për bazë me rastin e vendosjes dhe e refuzoi këtë kërkesë sepse marrëdhënia e punës dhe dhënjet materiale janë kompetencë e Gjykatës Themelore.

Gjykata pas pranimit të lëndës, analizimit të sajë, ka gjetur se është kompetente për të vendosur në këtë çështje, vlerësimin e kompetencës e ka bërë në bazë deklarimeve në padi konform nenit 17.1 dhe 2 dhe neni 79 të LPK-së. Kjo gjykatë është kompetente sepse kemi të bëjmë me kompensim dëmi-paga të pa paguar (dhënje materiale), konteste që burojnë nga mardhënja e punës.

Me Ligjin e Procedurës Kontestimore (LPK), është e rregulluar kompetenca për kontestet nga mardhënja e punës neni 49. Kontestet nga mardhënja e punës, konsiderohen të gjitha ato mosmarrëveshje ndërmjet punëdhënësit dhe të punësuarit, mosmarrëveshjet të cilat burojnë nga mardhënja e tyre. Tipike të kësaj natyre janë denoncimet e kontratës së punëtorit , mos pagesa e pagës së punëtorit. Për këto arsye gjykata vendosi që të mos shpallet jo kompetente në kuptimin lëndor dhe çështjen ta gjykoj vetë.

Po ashtu e ka analizuar edhe pretendimin se shkresa e lëshuar nga MAP nuk ka fuqinë e vendimit dhe nuk është e obliguar për të paditurën , këto pretendime gjykata nuk i mori për bazë me rastin e vendosjes, sepse shkresa e datë 20.11.2014, është e obligueshme për institucioneve të cilave ju ka drejtuar edhe ate: sekretarët e përgjithshëm të ministrive, drejtorët e agjencive ekzekutive dhe menagjeret e personelit që ta bani harmonizimin standardizimin e kofecientit për pozitat. Po ashtu kjo shkresë përmban edhe afatin deri kur duhet të ekzekutohet është shënuar se institucionet janë të obliguara që deri më datën 10.12.2014, ti harmonizojnë akt-emërimin dhe kofecientët për pozitat e lartë përmendura dhe ti dërgojnë në divizionin e pagave në MAP-DASHC.

Gjykata e ka analizuar edhe pretendimin se kjo shkresë nuk e obligon të paditurën këtë pretendim nuk e mori për bazë sepse shkresa e datës 20.11.2014, e nxjerrë nga Republika e Kosovës-Qeveria-MAP-Departamenti i Administratës Shërbimit Civil, e cila ju ka drejtuar sekretarët e përgjithshëm të ministrive, drejtorët e agjencive ekzekutive dhe menagjeret e personelit në këtë rast i obligonë menagjerët e personelit të paditurës të marrin veprime për vendosjen e këtyre koeficientëve.

Gjykata e detyroi palën e paditur që paditësit t'ia paguaj shpenzimet e procedurës kontestimore në shumë prej 3,757.60€, edhe atë shumën prej 624 € për përpilimin e padisë, shumën prej 2,433.60€, për tri seanc të përfaqësuara nga avokati , shumën prej 600€, për ekspertizën e ekspertit financiarë si dhe shumën prej 100 € në emër të taksës për padi dhe aktgjykim. (të parapara sipas udhëzimit administrativ nr.2008/02 të Këshillit Gjyqësorë) ,gjykata vendimi mbi shpenzimet e procedurës kontestimore e ka bazuar në nenin 452.1,453 dhe 449 të LPK-së.

Siç u theksua më lart dhe në bazë të rezultatit të tërë procedurës lidhur me çështjen kontestimore juridiko –civile , kjo gjykatë gjykoj dhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

Dega në Kaçanik

C.nr.2023:083992 prej datës 08/01/2025

Gjyqtari

Riza Livoreka

UDHËZIME JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi pala e pa kënaqur, ka të drejtë të paraqes ankesë , në afat prej 15 ditëve, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, ankesa i paraqitet Gjykatës së Apelit në Prishtinë përmes kësaj gjykate.

Dërguar me datën 14/01/2024

Paditësit 1x1

Të paditurit 1x1